

EBI

Stadt Bielefeld
Schulische Beratung
und Integration

🌐 www.bielefeld.de | www.ki-bielefeld.de

**Këshilla shkollore
sidhe integrim**

Albanisch



Dëftues botimi

Botuesi:



Niederwall 23
33602 Bielefeld

Përgjegjës për përmbajtjen:

Nilgün Isfendiyar
Kommunales Integrationszentrum

Redaksioni:

Miriam El-Dajani, Karolina Dombek,
Monika Schelp-Eckhardt, Mürüvet Yeşilgöz

Në bashkëpunim me:

Schulamt für die Stadt Bielefeld
REGE mbH (Regionale Personalentwicklungsgesellschaft mbH)
Kommunale Koordinierung im Übergang Schule – Beruf
Gesundheits-, Veterinär- und Lebensmittelüberwachungsamt Bielefeld
– Kinder- und Jugendgesundheitsdienst –
Amt für Schule, Regionale Schulberatungsstelle
Amt für soziale Leistungen – Sozialamt – Abteilung Sozialarbeit für Flüchtlinge

Dizajni:

com,ma Werbeberatung GmbH

Financuar nga:

Ministerium für
Schule und Bildung
des Landes Nordrhein-Westfalen



Ministerium für Kinder, Familie,
Flüchtlinge und Integration
des Landes Nordrhein-Westfalen



www.ki-bielefeld.de / www.bielefeld.de



09/2019

„...mësim dhe zbulim.“
Saad, 11

„...të mësoj gjuhën
gjermane“
Falah, 15

Shkolla do të thotë për mua...

„...një shtëpi
e dytë.“
Hazheen, 15



„...të mësoj
shumë.“
Timmi, 6

„...të zgjeroj,
diturinë time.“
Mia, 14

„...të jem i pregaditur për
jetën profesionale.“
Sherwan, 16

„...të gjejë shokë të ri.“
Mariam, 8



Përmbajtje

1. Hyrja	5
2. Këshilla.....	6
3. Regjistrimi në Shkollë	9
4. Mirëseardhja në Shkollë.....	10
5. Partnerët bashkëpunues komunal	11
6. Glosari	16

1. Hyrja

Të dashur prindër, të dashur fëmijë, të dashura familje, mirë se vini në Bielefeld!

Ju jeni të ri në qytetin tonë dhe kërkon një shkollë për fëmijën tuaj ose për fëmijët tuaj. Qendra e Integritimit Komunal Bielefeld (Kommunales Integrationszentrum) dhe Rege mbH do t'ju ndihmojnë!

Këshilla shkollore është për të gjithë fëmijtë dhe adoleshentët që janë të rinjë në Bielefeld dhe nga jashtëvendi.

Në Nordrhein-Westfalen, të gjithë fëmijët dhe adoleshentët nga 6 deri në 18 vjeç duhet të shkojnë në shkollë. Kjo do të thotë se ata janë „të obliguar që të shkojnë në shkollë“ (schulpflichtig).

Në qendrën e integritimit komunal (Kommunales Integrationszentrum), të gjithë fëmijët nga 5 deri 16 vjeç marrin këshillim shkollore. Ata pastaj regjistrohen në shkollat fillore ose të mëtejshme.

Në Rege mbH, këshillohen të gjithë adoleshentët e moshës 16–18 vjeç dhe pastaj regjistrohen në kolegjet profesionale.

Në këtë broshurë do të merrni informacione të rëndësishme për fillimin e shkollës në Bielefeld.

Gëzoni leximin! 😊



2. Këshillimi

Së pari, regjistroni veten dhe familjen tuaj në Bürgerberatung në Këshillin e ri të Komunës (Neues Rathaus). Qendra për këshillat e qytetarëve i dërgon këto informata Qendrës së Integritimit Komunal (Kommunales Integrationszentrum). Më pas do të merrni një letër me postë. Ju lutemi kontaktoni këshilltarët. Ju mund të vini direkt në qendrën komunale të integritimit me fëmijën tuaj ose telefononi dhe bëni një takim.

Cilat dokumente duhet ti sjellni?

- ID-Kartën ose Pasaportën
- Konfirmimi i Regjistrimit nga Zyra civile (Anmeldebestätigung)
- Dëftesat e fundit shkollore, nëse janë në posedim

Nëse nuk flisni gjermanisht, ju lutemi të sillni një person që përkthen për ju.

Konsultimi mund të zhvillohet edhe në këto gjuhë:

- Angleze
- Turke
- Polake
- Spanjolle

Për gjuhët e tjera, ka përkthyes që mund të ftohen nga Qendra e Integritimit Komunal (Kommunales Integrationszentrum) për të përkthyer.

Përmbajtjet e Këshillimit

Ju do të vini me fëmijën tuaj në qendrën e integritimit komunal (Kommunales Integrationszentrum). Kjo është e rëndësishme sepse këshilltarët duan të njohin personalisht fëmijën tuaj.

Ligjërisht, cekët në Nenin 12 të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës se gjithashtu duhet të përfshihet vullneti i fëmijës në të gjitha fushat.

Këshilltarët regjistrojnë të dhënat e fëmijës suaj. Këtu përfshihen emri, mosha, adresa dhe frekuentimi paraprak i shkollës.

Këshilltarët duan të dinë nëse fëmija i tyre mund të lexojë dhe të shkruajë shkrimin latin dhe nëse ai tashmë e kuptonë gjuhën gjermane.

Më pas do të merrni informacione rreth sistemit shkollorë në Nordrhein-Westfalen.

Pas këshillimit, këshilltarët kërkojnë një shkollë të përshtatshme për fëmijën tuaj. Atje, fëmijët së pari mund të mësojnë gjuhën gjermane.

Fëmijët nga 6 deri në 10 vjeç shkojnë në shkollë fillore (Grundschule).

Fëmijët prej 10 deri në 16 vjeç ndjekin një shkollë të mëtejme për mësimin e gjuhës gjermane. Ka lloje të ndryshme të shkollave:

- Gymnasium
- Gesamtschule
- Sekundarschule
- Realschule
- Hauptschule



REGE ju këshillon ju dhe fëmijën tuaj nëse ky është 16 vjeç ose më i vjetër.

Në këshillimet në qendrën e integrimit komunal (Kommunales Integrationszentrum) dhe në **REGE** ju gjithashtu merrni informata për kontrollimet në Entin e shëndetësisë.

Nëse keni nevojë për ndonjë informacion tjetër, këshilltarët do t'ju ndihmojnë me dëshirë, për shembull, në kërkim të ofertave për kohë të lirë, sporte dhe për pushime shkollore.



**Ekipi i këshillimit në qendrën e integrimit komunal
(Kommunales Integrationszentrum)**

Kontakti

Neues Rathaus, Niederwall 23, 33602 Bielefeld

Telefon: (0521) 51 34 11
(0521) 51 27 95
(0521) 51 85 21

E-Mail:
komm.integrationszentrum@bielefeld.de

3. Regjistrimi në shkollë

Nëse gjendet një shkollë e përshtatshme, atëherë ju do të merrni një mesazh nga Qendra e Integrimit Komunal (Kommunales Integrationszentrum):

Këshilltarët ju bëjnë thirrje juve ose personit të kontaktit, ose ju si prindër do të merrni një letër informacioni. Në të do të gjeni një termin dhe adresën për regjistrim në shkollë.

Në datën e regjistrimit në shkollë do të merrni të gjitha informatat e rëndësishme për vizitën në shkollë.

Ju lutemi të sillni me vete fëmijën tuaj dhe dokumentet më të rëndësishme siq janë:

- Pasaporta
- Çertifikata e lindjes
- Vërtetimi i Regjistrimit (Anmeldebestätigung)
- Dëftesat e shkollës

Nëse nuk flisni mjaft gjermanisht, mund të sillni një person për t'ju përkthyer.

Nëse rruga për në shkollë është më e gjatë, atëherë përgjatë regjistrimit në Sekretariat mund të shtrohet kërkesë për një biletë udhëtimi për në shkollë (shiko ne glosar Schulwegticket).

Pas regjistrimit, fëmija juaj mund të fillojë në shkollë!

4. Mirësevini në shkollë

Në cilën klasë mëson fëmija im?

Fëmija juaj është i ri në Bielefeld dhe ende flet pak ose aspak gjermanisht. Ende ka nevojë në fillim për ndihmë në shkollë. Moshë dhe përvoja e mëparshme e shkollës përcaktojnë se në cilën klasë do të vie fëmija juaj.

Ka 3 modele për përkrahje të gjermanishtës. Secila shkollë në Bielefeld vendosë vet se cilin model don që ta ofron:

Modeli 1: Fëmija juaj ndjek një klasë të rregullt dhe merr 4 orë në javë mësim gjerman në një grup të vogël për përkrahje të gjermanishtës.

Modeli 2: Fëmija juaj viziton një grup mësimi prej 10 deri në 12 orë në javë. Ndërsa pjesën tjetër të mësimi fëmija juaj është në një klasë të rregulltë.

Modeli 3: Fëmija juaj ndjek një klasë ndërkombëtare në shkollë dhe mëson atje gjermanisht dhe ka mësim vetëm në këtë klasë. Përveç gjermanishtës, ka edhe mësimemarrje, për shembull në matematikë, sport dhe art. Kjo është e rëndësishme: Çdo lëndë mësimorë ka fjalët dhe tekstet e veta që fëmija duhet ti kuptojë.

Shkolla dhe mësimet janë të ndryshme në çdo vend. Fëmija juaj do të ketë kohë të mjaftueshme për të përshtatet me shkollën e re në Bielefeld.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me shkollën ose fëmijën tuaj, ju mund t'i drejtoheni mësuesve të fëmijës suaj.

Sa do të marrë fëmija im përkrahje mësimi gjerman?

Sapo të është regjistruar fëmija juaj në një shkollë, ai do ti ka dy vite për të mësuar gjermanishten. Nëse fëmijës juaj i nevojitet më pak

kohë, përkrahja për mësim të gjermanishtës mund të përfundojë më herët.

Por ka edhe arsye pse disa fëmijë marrin ndihmesa për mësim të gjuhës gjermane më shumë se dy vite sepse:

- Ata kurrë nuk kanë qënë në shkollë.
- Ende duhet të mësojnë të lexojnë dhe të shkruajnë në shkrimin latin.

Kur mëson fëmija im vetëm në klasën e rregullt?

Mësuesit e fëmijës suaj vendosin së bashku, se kur do të mësojë fëmija i juaj vetëm në një klasë të rregullt.

Të rëndësishme për këtë vendim janë:

- Progresi në gjuhën gjermane dhe
- Arritjet shkollore

Ata gjithashtu vendosin nëse fëmija juaj ka nevojë të kalojë në një shkollë tjetër. Kjo mund të ndodhë nëse performanca e shkollës nuk i përshtatet tipit të shkollës.

5. Partnerët bashkpunues komunal

Enti shkollorë për Komunën e Bielefeldit



Enti shkollorë për qytetin e Bielefeld ka mbikëqyrjen për shkolla fillore (Shkalla primare), shkolla speciale (primare dhe sekundare) dhe shkolla kryesore (Hauptschulen).

Enti shkollorë i formon klasat për ndihmesë në gjermanishte.

Nëse një fëmijë flet një gjuhë tjetër, atëherë ai mund ti ndjekë mësimet në atë gjuhë. Mësimi quhet HSU (shih glosarin Herkunftssprachlicher Unterricht). Mësimdhënësit dhënë mësimë në gjuhën shqipe, arabe, greke, italiane, kurde, polake, ruse, spanjolle dhe turke.

Enti shkollorë ndihmon lidhur me pyetjet.

Kontakt

Neues Rathaus, Niederwall 23, 33602 Bielefeld

Eduard Rammert – Generalist Integration

E-Mail:

eduard.rammert@bielefeld.de

Gabriele Koch – Fachberatung Integration

Telefon: (0521) 51 8351

E-Mail:

gabriele.koch2@bielefeld.de

Zyra e zyrës së shkollës

Telefon:

(0521) 51 2343

Sekretariati Mbikëqyrja e shkollës Shkolla fillore

Telefon:

(0521) 51 2347

Sekretariati mbikëqyrës shkollor Haupt- dhe Förderschulen

Telefon: (0521) 51 3914

REGE

Nëse fëmija juaj është ndërmjet moshës 16 dhe 18 vjeç, REGE mbH mund t'ju ndihmojë të gjeni një shkollë.

Të gjithë adoleshentët nga 16 deri në 18 vjeç janë të obliguar që të ndjekin një shkollë profesionale.

Në bisedë, këshilltarët pyesin për përvojat shkollore të fëmijës suaj. Pastaj fëmija juaj fillon në një kolegji profesional ose në një shkollë tjetër. Shpesh fëmija juaj mëson gjermanisht në klasat ndërkombëtare ndihmuese për gjermanishtë dhe pastaj vazhdon shkollimin e tij.

REGE gjithashtu këshillon të gjithë të rriturit e rinj deri në 27 vite lidhur me:

- Kurse të gjuhës gjermane
- Diplomime shkollore
- Aplikime
- Praktika
- Profesionmarrje
- Puna

Kontakt

REGE

Kommunale Koordinierung im Übergang Schule-Beruf

Herforder Str. 73, 33602 Bielefeld

Telefon: (0521) 96 22-0

E-Mail: service@rege-mbh.de



Stadt Bielefeld

Gesundheits-, Veterinär- und
Lebensmittelüberwachungsamt

Shërbimi Shëndetësor i Fëmijëve dhe Rinisë

Mjekët ju ftojnë ju dhe fëmijën tuaj në një kontrollë para hyrjes në shkollë (Schuleingangsuntersuchung). Çdo fëmijë që jeton dhe shkon në shkollë në Bielefeld i bëhet ky kontroll. Kontrollimi është obligativ për të gjithë fëmijët. Kjo është në ligjin e shkollës.

Ftesën lidhur me këtë kontrollë do ta merrni nëpërmes postës.

Çfarë ndodh përgjatë kontrollimit?

- Mjekët do të ju shtrojnë pyetje në lidhje me zhvillimin dhe shëndetin e fëmijës suaj.
- Do të pyteni lidhur me statusin e vaksinimit.
- Do të bëhet matja e gjatësisë sidhe peshës së trupit
- Do të kontrollohen: sytë, veshët, zemra, mushkëritë, stomaku dhe dhëmbët.
- Fëmija juaj do të bëjë një test të vizatimit, foljes sidhe lëvizjes.

Ky kontrollim nuk shkakon dhimbje. Dhe nuk ka gjilpëra.

Nëse egzistojnë, ju lutemi sillni në kontrollimin e fëmijës tuaj:

- Syzet dhe / ose aparatet e dëgjimit
- Librezën e vaksinimit
- Dokumentet e rëndësishme mjekësore

Në fund të kontrollimit, mjeku do të diskutojë rezultatin me ju.

Nëse fëmija juaj ka një sëmundje ose aftësi të kufizuar, e të cilat do ta vështirësonin pjesëmarrjen e tij në shkollë, atëherë me pëlqimin tuaj do të informohet shkolla. Atëherë fëmija juaj në shkollë do të marrë mbështetjen që i nevojitet.

Shkolla pranon një ekspertizë të mjekut shkollorë lidhur me kontrollën mjekësore. Edhe ju gjithashtu merrni një kopje.

Kontakt

Nikolaus-Dürkopp-Str. 5-9, 33602 Bielefeld

Sekretariat: Frau Heike Weinreich

Telefon: (0521) 51 3878

E-Mail: heike.weinreich@bielefeld.de



Qendra Rajonale e Këshillimit shkollorë (Regionale Schulberatungsstelle) ju këshillon dhe mbështet juve dhe fëmijën tuaj për probleme të ndryshme në shkollë.

Për shembull:

- Vështirësi me mësuesit
- Frikë nga shkolla
- Mungesa e shpeshtë dhe pa arsye në shkollë
- Frika nga provimet
- Vështirësi në mësim
- Probleme me nxënësitë dhe nxënësetë e tjera

Këshilla për ju dhe fëmijën tuaj është:

- Personale, Konfidenciale, Vullnetare, Pa pagesë, E pavarur nga shkolla

Kontakt

Turnerstr. 5-9, 33602 Bielefeld

Telefon: (0521) 51 6916

E-Mail: rsb@bielefeld.de

Qendra të tjera këshillimi pas arritjes

Qendrat këshilluese të radhës mund t'ju ndihmojnë juve dhe familjes tuaj pasi që keni arritur në Bielefeld. Këtu mundë të pranoni më shumë informacione dhe këshilla mbi temat: e përgjithshme, ligjore, shëndetësore dhe sociale, arsimore dhe profesionale, të kurseve gjuhësore dhe integruese sidhe çështjeve personale.

Logo	Qendra e këshillimit	Adresa	Telefon / Email
	Clearingstelle Informacion për emigrantët	Neues Rathaus Niederwall 23 Kati i parë, dhoma A05	(0521) 55 731 79
	Amt für soziale Leistungen - Sozialamt - Sozialarbeit für Flüchtlinge	Neues Rathaus Niederwall 23 Kati i II Dhoma B 240 - B252 dhe dhoma C 248 - C258	(0521) 51 32 97 sozialamt@bielefeld.de
	DRK Soziale Dienste OWL gGmbH	August-Bebel-Str. 8 33602 Bielefeld	(0521) 32 98 98 0 info@drk-bielefeld.de
	Jugendmigrationsdienst Bielefeld (deri 27 vite)	Arndtstr. 6-8 33602 Bielefeld	(0521) 13 65 722 jmd@awo-bielefeld.de
	Caritas	Turnerstr. 4 33602 Bielefeld	(0521) 96 19 0 info@caritas- bielefeld.de
	Diakonie	Schildescher Str. 101 33611 Bielefeld	(0521) 98892 500 info@diakonie-fuer-bielefeld.de

Glosari

A

Alphabetisierung / Alfabetizimi

Shkrimi gjerman i përket sistemit të shkrimit latin. Disa fëmijë ende nuk i njohin shkronjat latine sepse kanë mësuar një sistem tjetër të shkrimit në vendin e tyre. Fëmijët e tjerë duhet të mësojnë të lexojnë dhe të shkruajnë që nga fillimi. Në klasën e shkrim-leximit, ata gradualisht mësojnë të gjitha shkronjat dhe mund të lexojnë dhe të shkruajnë gjithnjë e më shumë fjalë, fjali dhe tekste.

B

BuT – Bildung und Teilhabe / Arsimit dhe pjesëmarrja

Paketa e Arsimit- dhe pjesëmarrjes (Bildungs- und Teilhabepaket) paguan pjesërisht për gjërat shkollore, ndihmesën paschkollore, ushqimin në menzë, udhëtimet shkollore dhe shumë më tepër. Për të marrë këtë ndihmë, duhet të plotësoni një formular aplikimi. Lidhur me këtë do të ju mbështesin Punonjësit social në shkollë.

E

Elternmitwirkung / Pjesëmarrja prindërore

Kur prindërit dhe shkolla punojnë së bashku, atëherë kjo është mirë për arsimin e fëmijëve. Në shkollë, ju si prindër, keni mundësi të ndryshme për t'u aktivizuar. Ju keni të drejtë të merrni pjesë në bordet shkollore. Kjo është në ligjin e shkollës.

Për shembull, mund të ndihmoni edhe në festat shkollore ose të punoni në projekte të tilla si kafeneja e prindërve.

F

Feststellungsprüfung / Provimi i vlerësimit

Fëmija juaj mund në fund të klasës së 10-të, të zëvendësojë provimin në gjuhë të huaj me provimin në gjuhën e tij familjare. Aplikimin për këtë Provimvlerësim mundeni që ta bëni përmes shkollës. Kjo do të thotë se ky provim zhvillohet jashtë shkollës dhe me një mësues ose mësuese të huaj dhe ju duhet të aplikoni për të. Informacionet lidhur me këtë i gjeni në shkollë.

G

Ganztagsbetreuung / Kujdesi gjithditore Gebundene Ganztagschule / Lidhja e shkollës gjithë-ditore

Ky model është në dispozicion të disa shkollave fillore dhe ato të shkollës së I sekondare. 3 deri në 4 hera në javë, për të gjithë nxënësit dhe nxënëset ka mësimarrje prej orës 8:00 deri më 15:00. Shkolla ofron një drekë të përditshme. Ngrënja e drekës është me pagesë dhe është me vetëdëshirë.

Offene Ganztagschule(OGS) / Shkollë e hapur gjithditore

Ky model është në dispozicion vetëm në shkollat fillore. Pjesëmarrja është vullnetare. Të drejtë për një vendë të tillë nuk ka. Për këtë kujdes me drekë ju duhet të paguani. Shpenzimet varen nga të ardhurat tuaja. Fëmijët marrin oferta të ndryshme nga fushat e artit dhe muzikës, lojërave dhe sporteve dhe u ndihmohet në kryerjen e detyrave të shtëpisë. Ketu ka përkujdesje edhe përgjatë pushimeve të shkollës.

Außerunterrichtliche Ganztags- und Betreuungsangebote / Oferat këshilluese për përkujdesje gjithditore sidhe jashtëmësimore

Ky model përdoret kryesisht në shkollat sekondare I. Për këto oferta duhet të paguani. Pjesëmarrja dhe shpenzimet janë të rregulluara fleksibilisht: Ju si prind, vendosni se në cilën ditë fëmija juaj duhet të marrë pjesë në përkujdesje.

H

Herkunftssprachlicher Unterricht (HSU) / Mësimarrja në gjuhën e origjinës

Pasi fëmija juaj ka mësuar gjermanisht, ai mund të marrë pjesë në mësimet e gjuhës amtare. Në këtë mësim, fëmija juaj do të praktikojë duke folur, duke lexuar dhe shkruar gjuhën e tij të familjes. Informohuni rreth kësaj mundësie në shkollë ose në Entin shkollorë të komunës së Bielefeldit (Schulamt).

K**Kindertageseinrichtungen / Çerdhe ditore**

Fëmijët që ende nuk kanë nevojë të shkojnë në shkollë mund të marrin pjesë në një çerdhe ditore (KiTa). Në KiTa ata luajnë së bashku me fëmijët e tjerë, mësojnë gjuhën gjermane dhe përgatiten për shkollë. Në neuen Rathaus të komunës, ka punonjës që mund të ju ndihmojnë të gjeni një vend të KiTa.

Klassenfahrten und Klassenausflüge / Ekskurzione gjithditore sidhe ekskurzione me klasë

Çdo shkollë organizon ekskurzione gjithditore dhe me klasë. Këto veprime janë shumë të rëndësishme sepse ato ndihmojnë klasën të njohin njëri-tjetrin më mirë. Fëmijët dhe adoleshentët gjithashtu mësojnë të jenë të respektueshëm dhe miqësorë me njëri-tjetrin. Përmes përvijës, nxënësit mund të mësojnë më mirë në shkollë.

Ju, si një prind, duhet të nënshkruani që fëmija juaj lejohet të bashkohet me ekskursionin e klasës ose atë gjithditore. Shkolla ju informon në kohë me një letër të prindërve.

P**Praktikum / Praktika**

Në praktikë, fëmija juaj, në një punishte do të njohë punën e një profesioni të veçantë. Ai do të mbledhë përvijën për jetën e mëvonshme profesionale dhe mëson atë që është e rëndësishme në punë. Përveç kësaj, fëmija juaj mund të provojë se a i pëlqen një profesion i caktuar.

S**Schulanmeldepflicht / Obligim për regjstrim shkollorë**

Ju duhet të regjistroni fëmijën tuaj në një shkollë.

Obligimi për t'u regjistruar është në ligjin e shkollës (§ 41, Pika. 1). Ta çregjistroni fëmijën nga shkolla mundeni për shembull atëherë kur baheni në një qytet tjetër.

Schulwegticket / Biletë udhëtimi për në shkollë

Fëmija juaj për kohën se sa zgjatë ndihmesa për gjermanishte do të marrë një biletë udhëtimi për në shkollë, nëse:

- Rruga për në shkollë është më e gjatë se 2 km
- Rruga për në shkollën e mëtejme është më e gjatë se 3,5 km

Biletën e udhëtimit për në shkollë, fëmija i juaj e merr në fillim të vitit shkollorë. Kërkesën sidhe marrjen e biletës e bëni në shkollë. Deri sa fëmija juaj të marrë biletën, ju duhet të blini një biletë 4- she për fëmijën tuaj. Mbledhni biletat. Që pastaj të mundë ti merrni paratë nga shkolla, duhet të plotësoni një aplikacion në zyrën e shkollës dhe ta dorëzoni atë së bashku me biletat e mbledhura.

Nëse fëmija juaj e humbë biletën e udhëtimit për në shkollë, ai nuk do të marrë një të re nga shkolla. Pastaj duhet që ju të blini një biletë udhëtimi të re për në shkollë. Bileta e shkollës është e vlefshme vetëm për rrugën për në shkollë dhe për në shtëpi!

Bileta e shkollës është e vlefshme nga e hëna deri të premtën deri në orën 19:00 dhe të shtunën deri në orën 15:00.

Ju gjithashtu mund të blini një biletë argëtuese (Funticket) në mënyrë që fëmija juaj të mund të udhëtojë me autobus dhe tramvaj në çdo kohë, gjatë tërë muajit. Kjo biletë shtesë është Funticket. Nëse blini Funticket për një vit atëherë kjo kushtonë më pak.

Sonderpädagogischer Förderbedarf / Nevoja për ndihmesë të veçantë pedagogjike

Disa fëmijë kanë nevojë për mbështetje të veçantë në shkollë. Për këtë, shkolla sheh se nëse dhe çfarë ndihme ka nevojë për fëmijën tuaj. Ky shqyrtim quhet procedurë AOSF. Nëse njihet nevoja për ndihmesë, atëherë, fëmija juaj do të shkojë në një shkollë ndihmuese ose në një shkollë me një vend të të mësuarit të përbashkët.

U**Unfallversicherung / Sigurimi i aksidentit**

Fëmija juaj është i siguruar në rast aksidenti:

- Në rrugën nga shtëpia në shkollë
- Në rrugën prej shkollës në shtëpi
- Përgjat kohës që është në shkollë
- Në organizimet në shkollë dhe nga shkolla

Për më shumë informacione, kontakti zyrën shkollorë të shkollës.

